

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
2025

Nr. Rendor¹	Data e kërkesës²	Objekti i kërkesës³	Data e përgjigjes⁴	Përgjigje⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës⁶	Tarifa⁷
1.	23.12.2024	Përsëhëndetje. Pranë Inspektoratit Qendror është administruar në formë elektronike kërkesa për informacion e drejtor ekzekutiv i organizatës jofitimprurëse Qendra “Centre for Legal Empoëerment”, përmes së cilës kërkon informacion, si vijon: A janë kryer inspektime në fshatin Bërdicë (përfshirë dhe zonën e mbrojtur)? Nëse po, të vihen në dispozicion kopje të raporteve për inspektimet e kryera. A është konstatuar nëse ushtrohet veprimtari minerare me karrierë (gurore) në fshatin Bërdicë (në zonën e mbrojtur dhe jashtë saj)? A janë konstatuar shkelje të kuadrit ligjor në fuqi nga subjektet që ushtrojnë veprimtari	07.01.2025	Përsëhëndetje, Në vijim të informacionit të dërguar në lidhje me inspektimet në fshatin Bërdicë përfshirë dhe zonën e mbrojtur nga institucioni i IKMT-së informojmë si më poshtë: Duke u mbështetur në informacionet e marra nga Drejtoria e Mjedisit dhe Ujrave në Drejtorinë Qendrore, si dhe verifikimin e bërë nga Drejtoria Rajonale Shkodër, nuk rezulton që të jetë kryer inspektim në zonën e Bërdicës. Gjithashtu ju njoftojmë se në këtë zonë nuk rezulton të ketë veprimtari minerare me karrierë (gurore). Ju falenderojmë për mirëkuptimin	Kthim përgjigje (07.01.2025)	Nuk ka

		minerare me karrierë (gurore) në fshatin Bërdicë? Nëse po, çfarë masash janë marrë, si dhe të vendosen në dispozicion kopje të masave të marra. Sa më sipër, në zbatim të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, I				
2	08.01.2025	Drejtuar: Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit Tiranë Për dijeni: Inspektoriatit Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit Përshëndetje, Duke u mbështetur në Ligjin Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe në përputhje me nenet e këtij ligji, i cili rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, ju drejtojmë me këtë kërkesë për të marrë informacionin e mëposhtëm: 1. Sa herë është gjobitur nga institucioni juaj shtetasi, , banues i mëparshëm në Shkozë,?	09.01.2025	Përshëndetje , Drejtuar: Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë Në adresën e-mailit të koordinatorit të të drejtës për informim, IKMT, është paraqitur për dijeni kërkesa nga, për informacion mbështetur në Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”. Bashkëlidhur po Ju përcjellim për kompetencë kërkesën sipas ligjit të sipërcituar paraqitur nga ...për verifikim dhe trajtim nga ana Juaj. Faleminderit për bashkëpunimin!	Per kompetence	Nuk ka

		2. Cilat kanë qenë shkeljet përkatëse nga ana e, duke vendosur në dispozicion kopjet e vendimeve? 3. A i ka shlyer ai detyrimet dhe nëse jo, sa është vlera e gjobave sot, duke llogaritur dhe kamatëvonesat? Bazuar në detyrimet ligjore për transparencë dhe në të drejtën e qytetarëve për t'u informuar, presim që të na mundësoni informacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi. Duke ju falënderuar paraprakisht për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të një përgjigjeje sa më të shpejtë nga ana juaj. Me respekt,				
3	11.02.2025	Në kuadër të transparencës publike, duke u bazuar tek ligji nr. 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit" i ndryshuar, ju kërkojmë: 1. Listën e plotë të subjekteve ndaj të cilave janë marra masa administrative nga	20.02.2025	I nderuar Në vijim të kërkesës suaj për informacion me Nr. 3 Rendro, datë 11.02.2025, po ju përcjellim të dhënat e kërkuara në lidhje me masat administrative të vendosura nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) gjatë periudhës 2018-2024, si më poshtë:	Kthim pergjigje (20.02.2025)	Nuk ka

		Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit në vitin 2018.		Viti 2018	110 masa administrative (gjoba)		
		2. Listën e plotë të subjekteve ndaj të cilave janë marra masa administrative nga		Viti 2019	275 masa administrative (gjoba)		
		Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit në vitin 2019.		Viti 2020	223 masa administrative (gjoba)		
		3. Listën e plotë të subjekteve ndaj të cilave janë marra masa administrative nga		Viti 2021	161 masa administrative (gjoba)		
		Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit në vitin 2020.		Viti 2022	308 masa administrative (gjoba)		
		4. Listën e plotë të subjekteve ndaj të cilave janë marra masa administrative nga		Viti 2023	307 masa administrative (gjoba)		
		Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit në vitin 2021.		Viti 2024	447 masa administrative (gjoba)		
		5. Listën e plotë të subjekteve ndaj të cilave janë marra masa administrative nga		Faleminderit			

		Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit në vitin 2022. 6. Listën e plotë të subjekteve ndaj të cilave janë marra masa administrative nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit në vitin 2023. 7. Listën e plotë të subjekteve ndaj të cilave janë marra masa administrative nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit në vitin 2024.				
4	27.02.2025	Kërkesë për Informacion mbi Amnistinë e Gjobave Bazuar në ligjin nr. 119/2014 PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT mbështetur në nenin 3 të këtij ligji. Po ju shkruaj për të kërkuar informacion në lidhje me amnistinë e gjobave, pasi kam lexuar se Neni 2	10.03.2025	E nderuar Bazuar në kërkesën tuaj për informacion mbi amnistinë e gjobave për subjektin me NIPT:, në emër të subjektit, për dënimin me gjobë nr., ju njoftojmë se, sipas nenit 2 të ligjit 127/2024, përfitues të amnistisë janë: 1. Individët dhe/ose personat fizikë apo juridikë, të cilët kanë kryer ndërtime dhe/ose ndërhyrje pa leje apo	Kthim pergjigje (10.03.2025)	Nuk ka

	Përfituesit 1. Individët dhe/ose personat fizikë apo juridikë, të cilët kanë bërë ndërtime dhe/ose ndërhyrje pa leje apo njoftim paraprak, në ndërtime për qëllime banimi, në objekte ku kryhen veprimtari të prodhimit, magazinimit, përpunimit, ruajtjes dhe tregtimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale, si dhe mbajtjes të mjeteve të punës e inuteve bujqësore dhe blegtorale. 2. Individët dhe/ose personat fizikë apo juridikë, të cilët kanë objekt të aktivitetit të tyre prodhimin, përpunimin, ruajtjen dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në zonat rurale. 3. Individët dhe/ose personat fizikë apo juridikë, të cilët nuk kanë zbatuar rregullat e vendosura për administrimin e situatës COVID-19 gjatë periudhës së pandemisë. Pasi jam gjobitur nga IKMT Vendimi nr. 20, datë 12.02.2024 Për dënimin me gjobë nr. serie për një strukturë druri të çmontueshme.		njoftim paraprak, në ndërtime për qëllime banimi, në objekte ku kryhen veprimtari të prodhimit, magazinimit, përpunimit, ruajtjes dhe tregtimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale, si dhe mbajtjes së mjeteve të punës e inuteve bujqësore dhe blegtorale. 2. Individët dhe/ose personat fizikë apo juridikë, të cilët kanë objekt të aktivitetit të tyre prodhimin, përpunimin, ruajtjen dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në IKMT ju informon se objekti juaj bën pjesë në fushën e shërbimit. Faleminderit,		
--	---	--	---	--	--

		Veprimtaria ime ka qënë ne mirmbajtjen e zones si dhe tregetimin promovimin e produkteve agroushqimore, produkteve artizanale ...(sikurse është e pasqyruar ne ekstraktin tim bashkalidhur) Vendi zhvillimit ka qen ne zonen rurale Fshati Navosel Përmet Ju lutem, më informoni nëse unë jam përfitues i kësaj amnistie dhe cilat janë hapat që duhet të ndjek për të përfituar nga kjo mundësi. Me respekt! Faleminderit për ndihmën tuaj!				
5	06.03.2025	Përshëndetje, Përshkruani çdo veprim të pretenduar si shkelje nga Institucioni Publik dhe nëse dispononi dokumente bashkëlidhini ato. Më 11 shkurt 2025 i kemi bërë një kërkesë për informacion Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit për listën e plotë të subjekteve ndaj të cilave janë marra masa administrative nga	19.03.2025	Përshëndetje, Në përgjigje të kërkesës tuaj drejtuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr.1727 prot., datë 12.03.2025 në lidhje me pretendimet për mosdhënie të informacionit nga ana e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit përsa i përket kërkesës suaj për informacion nëpërmjet e-mail-it për <i>“Listën e plotë të subjekteve ndaj të cilave janë marrë masa administrative nga IKMT-ja gjatë periudhës 2018-2024”</i>, ju bëjmë më dije se:	Kthim përgjigje (19.03.2025)	Nuk ka

	IKMT-ja për periudhën 2018-2024. Më 20 shkurt 2025 Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit nuk na ka vendosur në dispozicion listën e plotë të subjekteve, por na ka dhënë përgjigje statistikore e cila nuk lidhet me kërkesën tonë për informacion. Në këtë rast Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit është duke shkelur të drejtën që na mundëson ligji nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar, ku edhe mosdhënia e informacionit quhet refuzim. Përshkruani çfarë kërkon nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me nenin 24 të ligjit nr.119/2014. Nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit kërkojmë që ta detyrojë Inspektoriatin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, që të respektojë ligjin nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar pasi ky është informacion publik për të cilin ne kemi të drejtë të informohemi dhe	Për sa paraqitet në këtë kërkesë, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ju ka mundësuar të dhëna faktike dhe statistikore në lidhje me gjobat si masa administrative të marra nga IKMT-ja për secilin vit të periudhës 2018-2024. Bazuar në ligjin nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar si dhe në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, neni 17 mbi kufizimin e të drejtës për informim, në ligjin nr.84/2016 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” dhe në ligjin nr.109/2016 “Për procedurat administrative”, ju informojmë se: Lista e subjekteve në interesin tuaj përfshin emra të individëve të lidhur me shkeljen, ndaj sipas ligjit aplikohen kufizime me qëllim mbrojtjen e privatësisë së tyre. Në disa raste, masat administrative të dhëna nga IKMT-ja ndër vite janë në procese gjyqësore dhe si rrjedhojë publikimi i tyre është i ndaluar deri në përfundim të procesit ose të apelimit të vendimeve të marra nga autoritetet përkatëse. Gjithashtu, disa subjekte		
--	--	---	--	--

		të na vendos në dispozicion informacionin e kërkuar në mënyrë të plotë brenda afateve të përcaktuara sipas ligjit në fuqi.		mund të jenë pjesë e një shqyrtimi administrativ në proces. Informacioni për emrat e subjekteve të gjobitur është i ndjeshëm dhe mund të ndikojë negativisht në reputacionin e individëve dhe bizneseve. Ligji garanton mbrojtjen e këtyre të dhënave për të shmangur diskriminimin ose dëmtimin e reputacionit pa një arsye të ligjshme. Duke marrë në konsideratë rrezikun e dëmtimit të marrëdhënieve të punës dhe bashkëpunimit me subjektet e caktuara të prekura nga inspektimet dhe ndëshkimet për shkak të publikimit të informacionit, <i>Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit shpreh bashkëpunimin e tij për çdo informacion në interesin tuaj, për aq kohë sa ky " Nuk ndikon ndikon në mbarëvajtjen e procedurave të inspektimit" (ligji 119/2004, neni 17, pika 2.ç).</i> Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,		
--	--	---	--	--	--	--

6	10.03.2025	DREJTUAR: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Këshilli Kombëtar i Ujit OBJEKTI: Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion dokumentacioni 1- Çfarë lejesh disponon kompania “Gjoka Konstruksion” në Njësinë Administrative Zall-Dajt në shfrytëzimin e zonës së rrethuar krah “Rrugës së Arbit” (Lokacioni Google këtu: https://maps.app.goo.gl/oggzf9ipEJppDGSQA) që ndodhet në bashkimin e Lumit të Tiranës dhe Lumit të Selitës? Ju lutem listoni lejet e dhëna (nga institucioni juaj) dhe periudhat e vlefshmërisë së tyre (nëse aplikohet vlefshmëri kohore). 2- A disponon “Gjoka Konstruksion” leje për prodhim asfalti (ngrohje dhe distilim katrani e bitumi) në këtë zonë? Nëse po, ju lutem më siguroni një kopje elektronike (format PDF) të lejes përkatëse. 3- A disponon “Gjoka Konstruksion” leje për shfrytëzimin e mbetjeve dhe		Në vazhdimësi		
---	------------	---	--	---------------	--	--

		sedimenteve të Lumit të Tiranës në lokacionin e përmendur? Nëse po, ju lutem më siguroni një kopje elektronike (format PDF) të lejes përkatëse. 4- A ka kryer ndonjëherë inspektim Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit për veprimtarinë e kompanisë “Gjoka Konstruksion” në lokacionin e përmendur. maps.app.goo.gl Duke ju falënderuar paraprakisht për bashkëpunimin, mbetem në pritje të përgjigjes suaj!				
7	12.03.2025	Përsëhendetje, Shkresë nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit, e regjistruar me nr. rendor 7 dhe nr. protokolli 1727 tonën, datë 12.03.2025, mbi ankimimin për mosdhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare, në lidhje me kërkesën me nr. rendor 5, datë 06.03.2025.	23.04.2025	Përsëhendetje, Në vijim të kërkesës suaj për informacion me Nr. 6 Rendor, po ju përcjellim të dhënat e kërkuara në lidhje me listen e subjekteve ndaj të cileve janë marrë masat administrative (gjobë) të vendosura nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT)	Kthim pergjigje (23.04.2025)	Nuk ka

				gjatë periudhës 2018-2024, si më poshtë: Faleminderit.		
8	03.04.2025	Përsëndetje, Unë ... paraqes këtë ankesë ndaj Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit (IMT) për shmangien e përgjegjësisë dhe mungesën e një ekspertize teknike të saktë në lidhje me dëmet e shkaktuara në banesën time. Nga inspektimi i IMT-së, Nr protokoll 3424/2 është konstatuar që ka rrjedhje të vazhdueshme uji dhe prek direkt banesën mbi apartamentin tim, por pa asnjë provë konkrete, pa verifikim teknik të specializuar dhe duke përdorur vetëm “fotografi në mot të lagësht dhe të thatë”. Në këtë	14.04.2025	Përsëndetje, Nëpërmjet këtij e-maili dëshirojmë t’iu informojmë në lidhje me problematikën tuaj, trajtuar nga Inspektorati Kombëtarë i Mbrojtjes së Territorit, të cilën po u’a përcjell nëpërmjet këtij e-maili. Në zbatim të ligjit Nr.107/2014“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit“, i ndryshuar, neni 3, pika 20 dhe 21 përcaktohet se: <i>“Ndërtim” është çdo objekt që ndërtohet ose instalohet në territor, me vendosje të palëvizhme apo të përkoshme, dhe që zhvillohet nën dhe/ose mbi tokë. “Ndërtim/punim pa leje” janë ato procese dhe/ose objekte ndërtimore të kryera në</i>		

	mënyrë, IMT po favorizon palën përgjegjëse, fqinjit në katin e katërt, i cili ka kryer një ndërhyrje të paautorizuar në strukturën e pallatit, duke shkaktuar këto dëmtime. Për më tepër, dëmtimi në apartamentin tim është i brendshëm dhe është verifikuar nga teknikë të fushës, të cilët kanë konfirmuar që burimi i lagështirës është ndërhyrja e paligjshme në lavamanin t dhe jo amortizimi i pallatit. Kjo situatë prek një mur mbajtës, duke rrezikuar sigurinë e strukturës. IMT, në vend që të merrte masa konkrete, ka nxjerrë një justifikim të përgjithshëm, duke pretenduar se problemi është “jashtë juridiksionit të saj”. Kjo është e		<i>mungesë të lejes së ndërtimit, deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve ose të kryera në kushtet e një lejeje të shfuqizuar.</i> Në këtë kuptim, çdo objekt i ndërtuar në këto kushte, i nënshtrohet inspektimit të territorit, në zbatim të ligjit Nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar. Gjatë momentit të inspekimit, IMT Bashkia Tiranë nuk ka konstatuar punime në proces dhe për këtë nuk mund të ndërhyhet. Ju falenderojmë paraprakisht për mirëkuptimin.		
--	--	--	---	--	--

		papranueshme, pasi dëmtimi është rezultat i një ndërhyrjeje të paautorizuar që bie nën përgjegjësinë e IMT-së dhe institucioneve përgjegjëse të Bashkisë Tiranë. Kërkoj që: 1. Të kryhet një ekspertizë e pavarur teknike nga një inxhinier ndërtimi të licencuar, për të përcaktuar burimin real të lagështirës dhe dëmtimet në murin mbajtës. 2. Të merren masa ligjore ndaj Silvio Dushit, si person përgjegjës për dëmtimet, dhe të detyrohet të riparojë dëmet e shkaktuara.				
--	--	---	--	--	--	--

		3. IMT të rishikojë vendimin e saj dhe të mos favorizojë palën përgjegjëse, por të marrë masa sipas detyrimeve të saj ligjore.				
9	24.04.2025	Pershendetje, Brema Ambiente dhe HSEM (Health Safety Environment Management), kanë kënaqësinë t'ju ftojnë të merrni pjesë në eventin : <i>“Siguria në Punë, Menaxhimi i Mbetjeve & Mjedisi”</i> Për më shumë informacion ose për të konfirmuar pjesëmarrjen	25.04.2025	Përshëndetje, Në adresën e institucionit (<i>info@ikmt.gov.al</i>) ka mbërritur ftesa për pjesëmarrje në eventin e organizuar nga Brema Ambiente dhe HSEM (Health Safety Environment Management), me temë: “Siguria në Punë, Menaxhimi i Mbetjeve & Mjedisi” Bashkëlidhur po ju dërgoj ftesën e cila përmban dhe kontaktin për të konfirmuar pjesëmarrjen. Faleminderit!		Nuk ka

		tuaj, ju lutemi na kontaktoni në email ose ne numrin : +355 69 542 0190.				
10	05.05.2025	Përsëndetje. Në vijim gjeni email e dërguar nga Shërbimet e Policisë Bashkiake të Tiranës, lidhur me konstatimin mbi ndotjen e liqenit artificial të Tiranës. Punë të mbarë! Pershendetje! Sherbimet e Policise Bashkiake te Tiranese kane konstuar , mbi ndotjen e liqenit artificial te Tiranes, ujë ngjyrë jeshile dhe erëra të pa këndshme si dhe peshq të ngordhur. Të njoftohen Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve,				Nuk ka

		Ujërave dhe Turizmit . Sherbimi jone 355692698514, Shefqet Pelushi. Pune te mbare!				
11	08.05.2025	Përshëndetje, Bashkëlidhur do të gjeni Kërkesën për informacion. Në pritje të një përgjigjeje sa më të shpejtë nga ana juaj, Faleminderit për bashkëpunimin.		Pershendetje, Në përgjigje të kërkesës suaj, dërguar në IKMT, nëpërmjet adresës elektronike, ku mbështetur në Ligjin Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, kërkohet informacion mbi situatën e konstatuar nga ana juaj në territorin e Bashkisë Shijak, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, nëpërmjet strukturave të saj nën varësi dhe përkatësisht Drejtorisë së Inspektimit në Mjedis dhe Ujëra, fillimisht ka komunikuar me sektorët përkatës të Drejtorisë Rajonale të IKMT-së Qarku Durrës, për t’u informuar nëse nga ana e kësaj drejtorie kishte informacion		Nuk ka

				mbi këtë situatë tepër shqetësuese. Nga ky komunikim jemi informuar se kjo drejtori dhe në muajin Mars dhe përgjatë muajit Prill ka dërguar shkresa informuese në Bashkinë Shijak mbi konstatimin që është kryer në terren nga ana e tyre, të situatës së keqmenaxhimit të mbetjeve që krijohen brenda njësisë administrative. Në të dyja rastet Bashkia Shijak ka informuar se së fundmi ka hasur në një ngërç burokratik në mardhënie me landfillin e Sharrës, ngërç i cili pritet të zgjidhet sa më shpejt. Pasi Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave në IKMT, ka marrë këtë informacion më datë 20.05.2025 ka hapur në sistemin unik <i>e-inspektimi</i>, një çështje për inspektim on-line kundrejt Bashkisë Shijak me Nr.-IKMT-DQ-2025-000139, me objekt inspektimi <i>“Bazuar në informacionet e marra nga mediat audio-vizive si dhe verifikimi në terren, kontroll mbi zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe atij të posaçëm për menaxhimin e integruar të Mbetjeve”</i> Në përfundim të këtij inspektimi i cili filloi në ora 09.00 dhe mbaroi në orën 14.00, të datës 20.05.2025, trupa inspektuese e D.I.M.U-së, mbajti Proçes-Verbalin e		
--	--	--	--	---	--	--

				konstatimit të kundravajtjes administrative me Nr.IKMT-DQ-2025-000139-2, kundrejt drejtuesit të njësisë qeverisjes vendore, kjo në zbatim dhe referuar Ligjit Nr.10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, neni 45 dhe Ligjit Nr.10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të mbetjeve” (Ndryshuar me ligjin nr. 32/2013, datë 14.2.2013; nr. 156/2013, datë 10.10.2013; nr. 28/2022, datë 17.3.2022; nr. 70/2024, datë 4.7.2024) (I përditësuar), Neni 21, pika 12 dhe Neni 62, Kundërvajtjet dhe sanksionet (shtuar pika 63 me ligjin nr. 32/2013, datë 14.2.2013; ndryshuar pika 48, shfuqizuar pika 51 me ligjin nr. 156/2013, datë 10.10.2013; shtuar pika 25/1 me ligjin nr. 28/2022, datë 17.3.2022; ndryshuar me ligjin nr. 70/2024, datë 4.7.2024), pika 11. Nëpërmjet këtij Proçes-Verbali organi inspektues ka urdhëruar/komunikuar drejtuesit të qeverisjes vendore marrjen e masave urgjente për rehabilitimin dhe pastrimin e vendeve (akse rrugore, lagje, sheshe,etj) të ndotura nga mbetjet urbane të përziera dhe njëkohësisht fillimin e operacioneve për rehabilitimin pastrimin e vend depozitimit në zonën e Hardhishtes.	
--	--	--	--	---	--

				Njëkohësisht ju bëjmë me dije se strukturat e Bashkisë Shijak më datë 22.05.2025, kanë filluar nga puna në terren me një intesitet të kënaqshëm për plotëzimin e detyrave të lëna nga ana e organit inspektues dhe informojnë institucionin tonë në çdo moment dhe në kohë reale mbi zhvillimet e operacioneve të rehabilitimit/pastrimit, i gjithë ky informacion pasi konfirmohet dhe nga ana e trupave inspektuese në terren, pasqyrohet sistematikisht në sistemin e inspektimit. Në përfundim ju informojmë se IKMT, me strukturat e saj nën varësi është në mbikqyrje të vazhdueshme të situatës mbi të cilën keni kërkuar informacion, dhe në zbatim të detyrave të saj funksionale do të vazhdojë të jetë operative në terren, për të konfirmuar/kontrolluar kryerjen e detyrave të lëna njësisë qeverisjes vendore, Bashkia Shijak. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin !		
12	05.05.2025	Dua të denoncoj një ndotje të madhe të mjedisit që po i bëhet gjithë lumit Erzen nga një subjekt privat që po ndërton një hidrocentral në fshatin Hekal, përballë Pellumbasit.	28.05.2025	Përsëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj me Nr. 11, datë 03.05.2025, ju njoftojmë se Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ka ngritur një grup	Kthim pergjigje (28.05.2025)	Nuk ka

		Unë jam një guidë që çdo vit shoqëroj të huaj në shpellën e Pellumbasit dhe në grykën e Skoranës, poshtë shpellës. Kjo grykë është një ndër vendet më të vizituara nga të huajt në Tiranë, me ujëvarat dhe zgavrat e mrekullueshme që ka. Fatkeqësisht, kjo zonë dhe ky turizëm janë dëmtuar nga veprimet e një firme që po kryen punime për ndërtimin e një hidrocentrali, si dhe nga neglizhenca e strukturave shtetërore. Kjo firmë ka hapur një tunel në digën e Skoranës dhe ka derdhur në lumë gjithë llumin dhe mbeturinat që kjo digë ka mbledhur prej dhjetëra vitesh. Sipas banorëve të fshatit Pellumbas, ata e kanë kundërshtuar këtë veprim, por nuk janë dëgjuar nga askush. Ky llum dhe këto mbeturina kanë dëmtuar rëndë gjithë lumin, duke e kthyer nga një lumë me ujë kristal në një lumë me ujë të ndotur dhe baltë, duke dëmtuar çdo gjë në rrjedhën e tij. Gjithë shtrati i lumit është mbushur me baltë dhe do të duhet shumë kohë për t'u rikuperuar. Zgavrat		pune i cili do të kryejë inspektim në zonën përreth lumit Erzen, me qëllim verifikimin e situatës së paraqitur në denoncimin tuaj lidhur me ndotjen mjedisore. Pas përfundimit të inspektimit dhe shqyrtimit të të gjitha rrethanave të konstatuara në terren, do të merren masat përkatëse në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe do të jeni i informuar mbi ecurinë dhe rezultatet e mëtejshme të procesit. Ju falënderojmë për bashkëpunimin.		
--	--	--	--	---	--	--

		fantastike që tërhiqnin turistë janë tani të shëmtuara dhe të dëmtuara nga lluca dhe uji i ndotur. Është e çuditshme sesi kjo situatë nuk është vënë re nga inspektoratet shtetërore, kur edhe nga autostrada dallohet qartë uji i ndotur që vjen nga lart. Kjo kompani, në vend që t'i pastrojë dhe t'i largojë mbeturinat me kamionë, i derdh të gjitha në lumë, duke i shkaktuar një dëm kolosal dhe të pariparueshëm mjedisit dhe të gjithëve ne që jetojmë dhe punojmë në këtë zonë. Banorët e Pellumbasit kanë lajmëruar inspektorët që kanë ardhur në fshat, por përgjigjja e tyre ka qenë: “Do t'i thërrasim,” dhe kanë refuzuar të shkojnë në vendin ku ndodh ndotja, me pretekstin se rruga është e vështirë dhe nuk kanë automjet të përshtatshëm për të shkuar deri tek diga e Skoranës. Atje ku, në fshehtësi, kjo firmë ka kryer një krim të rëndë mjedisor. Kjo neglizhencë e organeve shtetërore po falimenton biznesin tonë, pasi këtë vit ka një rënie drastike të vizitorëve, dhe po ashtu po shkatërron një nga zonat				
--	--	---	--	--	--	--

		më të bukura të Tiranës. Kemi informacion të sigurt që inspektorët janë kontaktuar nga përfaqësuesit e kësaj firme dhe janë “rregulluar” me forma të ndryshme, duke i injoruar denoncimet në këmbim të favoreve – diçka që e thonë të gjithë banorët e fshatit. Kërkojmë nga ana juaj marrjen e masave të menjëhershme për ndalimin e derdhjes së mbeturinave të digës së Skoranës në lumin Erzen, si dhe të ndërpritet çdo lloj ndotjeje e këtij lumi në këtë zonë. Nëse nuk merren masa të menjëhershme, do t’i drejtohem organeve përkatëse për të bërë kallëzim penal ndaj të gjithë atyre që kanë neglizhuar këtë çështje dhe që vazhdojnë ende të jenë indiferentë përballë këtij krimi mjedisor. Dua t’ju njoftoj se, nëse nga drejtuesi i institucionit tuaj nuk ndërhyhet menjëherë, do të bëj denoncim online në platformën e SPAK për shpërdorim detyre ndaj të gjithë drejtuesve të përfshirë, si dhe në Prokurorinë e Tiranës,				
--	--	---	--	--	--	--

		duke përfshirë edhe këtë email dhe këtë denoncim si provë. Duke pasur besim se kjo çështje do të merret seriozisht.				
--	--	--	--	--	--	--

Shënim:

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesave

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/E kufizuar/E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuara nga autoriteti publik.